

PLANIFIKIMI I ZBATIMIT TË KURRIKULËS PËR NJË PROCES MËSIMOR TË SUKSESSHËM NË DISTANCË/ONLINE

Qëllimi

Krijimi te mësuesit dhe instruktorët e Institucioneve ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) i aftësive profesionale për hartimin dhe zbatimin e planifikimeve të efektshme të kurrikulës së AFP-së, të kurrikulës bërthamë të formimit të përgjithshëm, nëpërmjet procesit mësimor në distancë/online.

Rezultatet e të nxënit

- shpjegojnë parimet pedagogjike mbi të cilat duhet të bazohen mësuesit/instruktorët gjatë procesit të hartimit të planifikimeve të zbatimit të kurrikulës
- identifikojnë dokumentacionin zyrtar mbi të cilat mësuesi/instruktori mbështetet për hartimin e planifikimeve të zbatimit të kurrikulës
- shqyrtojnë formatet/template të planifikimeve të zbatimit të kurrikulës për kurrikulën bërthamë të formimit të përgjithshëm dhe për kurrikulën e AFP-së
- analizojnë kolonën “platforma, metoda e teknika online” që i shtohet planifikimit të kurrikulës
- japin gjykime se si duhet krijuar mjedisi i punës për mësimin online në kushtet e shtëpisë
- diskutojnë rreth rolit dhe kontributit që jep ekipi lëndor i institucioni në procesin e hartimit, të përmirësimit dhe miratimit zyrtar të planifikimeve të zbatimit të kurrikulës
- shpjegojnë elementet e platformës online ‘google classroom’ dhe ‘google meet’

Planifikimi i kurrikulës

Planifikimi për zbatimin e kurrikulës nënkupton një tërësi të veprimtarive të organizuara nga mësuesi/instruktori, nga ekipet lëndore dhe nga Institucioni ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP), të cilët kanë për qëllim:

- Realizimin e kualifikimeve profesionale
- Formimin e kompetencave kyçe për nxënësit

LLOJET E PLANEVE MËSIMORE PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS TE IoAFP-të

Në shkollat e arsimit dhe formimit profesional hartohen dhe zbatohen tre lloje planifikimesh të zbatimit të kurrikulës në periudha kohore tremujore dhe vjetore. Ato janë rrjedhojë e kërkesave të programeve lëndore apo të moduleve, por dhe të skeletkurrikulave të kualifikimeve apo planeve të programeve të kurseve të unifikuara.

1. Plani mësimor për kurrikulën në bazë shkolle të AFP-së përfshin planin e zhvillimit të orëve mësimore (*Plani i zhvillimit të orëve mësimore nënkupton “Planin mësimor operativ”, që në këtë material përdoret “Plani i zhvillimit të orëve mësimore”*), programet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, programet e mësimdhënies të moduleve praktike profesionale, projektet e të nxënit dhe praktikat në biznes. Këto dokumente mbështeten fort tek pjesët korresponduese të dokumentit zyrtar të Skeletkurrikulës së Kualifikimeve (drejtimeve/profileve) profesionale të nivelit përkatës.

2. Plani mësimor për kurrikulën në bazë ofruesi të FP-së përfshin planin e programeve të e kurseve të unifikuara dhe të miratuara nga institucionet shtetërore, përkatëse, por dhe programe për kurse të tjera jo të unifikuara për formimin profesional që ofrohen nga vetë ofruesi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut lokal dhe atij rajonal të punës.

3. Plani mësimor për kurrikulën e formimit të përgjithshëm përfshin planin vjetor lëndor, planin tremujor, projektet kurrikulare dhe mbështetet në dokumentet zyrtare për kurrikulën e formimit të përgjithshëm në shkollat e mesme, profesionale.

Në procesin e zbatimit të kurrikulës përfshihen

1. Skeletkurrikulat e AFP-së
2. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
3. Programet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale
4. Programet e mësimdhënies të moduleve praktike profesionale
5. Programet lëndore të formimit të përgjithshëm
6. Tekstet shkollore
7. Labororët dhe mjetet didaktike
8. Mjediset e praktikës
9. Ekipi (lëndor/modular) i IoAFP-së (mësues/instruktorë)
10. Drejtoria e shkollës

Formati i planit mësimor për kurrikulën në bazë shkolle të AFP-së

Formati i programeve të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale ndërtohet si më poshtë:

Shkolla profesionale _____ Viti shkollor _____

Drejtimi/profili profesional _____ Niveli _____

Klasa ____, ____ orë mësimore

Nr	Temat/ kohëzgjatja	Çështjet	Koha	Objektivat/ Rezultatet mësimore	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizim	Platforma dhe teknikat online
1		1						
		2						
		3						
2		1						
		2						
		3						
		4						
3								
Etj								

Formati i planit mësimor për kurrikulën në bazë ofruesi të FP-së

Shkolla profesionale _____ Viti shkollor _____

Drejtimi/profili profesional _____ Niveli _____

Klasa ____, ____ orë mësimore _____

Nr	Rezultatet mësimore/ Kohëzgjatja	Veprimtaritë mësimore	Koha	Instrumentet e Vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizim	Platforma dhe teknikat online
1		1					
		2					
		3					
2		1					
		2					
		3					
		4					
3							
Etj							

PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES PËR KURRIKULËN BËRTHAMË TË KULTURËS/FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM

Llojet e planifikimeve të kurrikulës së formimit të përgjithshëm janë:

- Planifikimi vjetor
- Planifikimi tremujor për secilën periudhë
(Shtator-Dhjetor; Janar-Mars; Prill-Qershor)
- Planifikimi ditor

FORMATI I PLANIT MËSIMOR VJETOR PËRMBAN KËTO RUBRIKA:

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR -MARS	PRILL – QERSHOR

Formati i Planifikimit tremujor

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe (a)							
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës (b)							
Nr. (c)	Tematika /kapitulli (d)	Temat mësimore (e)	Situata e parashikuar e të nxënit (f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)	Platformat dhe teknikat on-line
Shembull (Letërsi)	Letërsia antike P.sh	Eskili “Prometeu i mbërthyer” P.sh.	Altruizmi në ditët tona	P.sh. Diskutim, Stuhi mendimesh, Punë në grup Punë në dyshe Etj.	P.sh., Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish	P.sh., Teksti i nxënësit, vepra Teksti i nxënësit, harta e Shqipërisë ose harta e Ballkanit	
Shembull (Matematikë)	Gjeometria në plan	Matja e gjatësive dhe këndeve (Aftësi)	Largesia në hartën e Shqipërisë ose të Ballkanit	P.sh. Diskutim, Stuhi mendimi Punë grup Punë në dyshe Etj	P.sh., Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish	P.sh., Teksti i nxënësit, vepra Teksti i nxënësit, harta e Shqipërisë ose harta e Ballkanit	

Hapat për një planifikim të efektshëm online të mësimdhënies

1.Parashikoni në planifikimet e zbatimit të kurrikulës platformat online bashkë me metodat apo teknikat përkatëse që do të përdorni

2.Planifikoni dhe krijoni klasat tuaja on-line

3.Përgatituni që të zotëroni teknologjinë

4.Krijoni një mjedis të përshtatshëm për punën online

5.Stimuloni diskutime dhe ndërveprim

6.Komunikoni rregullisht

7.I motivoni nxënësit/kursantët

8.Kërkoni ndihmë dhe reagime

Platforma online 'Google classroom'

Materialet që mund të futen në platformën 'Google Classroom'

Te "Classwork"

1. Programet lëndore/Plani i orës së mësimi
2. Materiale *word*
3. *Power Point Presentation*
4. Video (nga *youtube*, te realizuara nga pedagogu)
5. Teste / pyetje
6. Këshilla dhe njoftime nëpërmjet te "**Stream**"
7. Detyrat e nxënësve/kursantëve
8. Mund të shërbejë edhe si *blog* ku nxënësit/kursantët i përgjigjen një pyetje një çështje që ngre mësuesi/instruktori

Platforma 'Google meet'

1. Inicimi i një takimi me nxënësit/kursantët
2. Realizimi i takimeve virtuale

Pune praktike online

1. Platforma “Google classroom”
2. Platforma “Google meet”

<https://classroom.google.com/h>

Pyetje-diskutime

Ju faleminderit!